



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**STUDIMET PASUNIVERSITARE – CIKLI I DYTË MASTER**

**TEZA:**

***“NDIKIMI I STRATEGJIVE TË MARKETINGUT NË TËRHEQJEN E KLIENTËVE:  
RASTI I BANKAVE KOMERCIALE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT”***

**Kandidatja:** Lavdije Miftari

**Mentori:** Prof. Dr. Jusuf Zeqiri

**Tetovë, 2020**

## ABSTRAKTI

Strategjitë e marketingut dhe vlerat konsumatore janë dy komponenta me vlerë dhe rëndësi të veçantë për në një kompani bankare, sidomos në kompani të mëdha dhe të konsoliduara në tregun bankar, siç janë: në Republikën e Maqedonisë së Veriut: *Banka Komerciale (Komercijalna Banka)*, *Banka Ekonomike (Stopanska Banka)*, mbase edhe *Banka Teteks (Teteks Banka)*.

Synimi i punimit është të shtjelluarit e tematikës për të cilën bëhen shqyrtimet. Së këndejmi, shqyrtimet studimore dhe hulumtuese në këtë punim Masteri shtrihen dhe fokusohen në strategjitë e marketingut të bankave, në përgjithësi, në njërin anë, dhe të bankave komerciale të caktuara konkrete në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në veçanti, në anën tjetër, se si ato promovojnë dhe mbrojnë vlerat konsumatore të klientëve të tyre në një treg bankar kompetitiv (konkurrues) me qëllim të tërheqjes dhe shtimit (rritjes) të numrit të klientëve si persona, të cilët janë përdorues të shërbimeve bankare dhe financiare.

Metodat e hulumtimit për të realizuar këtë studim janë të ndryshme të cilat janë si empirike për kërkimin e informacionit të përgjithshëm teorik në lidhje me strategjitë e suksesshme të marketingut në sistemin bankar dhe metoda analitike dhe praktike në të cilën bazohet puna më e madhe e kryer për zhvillimin e hulumtimit. Në lidhje me studimin janë intervistuar një numër i konsiderueshëm punonjësish në bankat përkatëse të sipërtheksuara në të gjithë nivelet organizative duke filluar që nga menaxherët gjeneral dhe duke vazhduar me menaxherët marketing dhe me punonjësit në tërësi.

Si instrument për mbledhjen e të dhënave është përdorur një pyetësor i përgatitur personalisht duke zbatuar të gjitha rregullat e etikës për intervistimin, pyetësori përfshin 22 pyetje dhe është i ndarë në tre sektorë ku në sektorin e 1-rë studiohen aspektet demografike, në sektorin 2-të studiohen specifikisht strategjitë e marketingut dhe vlerat konsumatore të punonjësve të secilës bankë veç e veç (Banka Komerciale, Banka Ekonomike dhe Banka Teteks), ndërsa në sektorin e 3-të pyetjet kanë karakter sugjerues në lidhje me atë se si mund të përmirësohen më tepër strategjitë marketing dhe të rriten vlerat konsumatore. Rezultatet e studimit janë mjaft domethënëse dhe japin një informacion praktik

se si duhet të zhvillohen strategjitë e marketingut në një kompani bankare dhe se si duhet të zhvillohen dhe avancohen (rriten) vlerat konsumatore.

**Fjalët kyçe:** *Strategjitë e marketingut, vlera konsumatore, performanca, tërheqje e klientëve.*

## **TABELA E PËRMBAJTJES**

Abstrakt.....	3
Falenderime.....	4
<b>KAPITULLI I: HYRJE</b>	
1.1 Prezantim.....	8
1.2 Arsyetimi studimit.....	9
1.3 Qëllimi dhe objektivat.....	10
1.4 Sistemi bankare ne Republiken e Maqedonise se Verijut.....	10
1.5 Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat.....	12
1.6 Rëndësia e studimit.....	13
1.7 Kufizimet per realizimin e studimit.....	13
<b>KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS</b>	
2.1 Marrëdhënia mes strategjisë marketing dhe klientit.....	12
2.2 Çfarë quajmë vlerë konsumatore? .....	15
2.3 Modelet e vendimarrjes.....	
2.4 Orientimi i strategjisë marketing drejt vlerës së konsumatorëve .....	18
2.4.1 Parimet themelore të orientimit të strategjisë marketing drejt vlerës së konsumatorëve .....	19
2.4.2 Mënyra e orientimit strategjik të vlerës së klientit.....	20
2.5 Orientimi i strategjisë së vlerës së konsumatorëve dhe konkurrencës së kompanive.....	21
<b>KAPITULLI III: KRIJIMI I VLERËS KONSUMATORE</b>	
3.1 Matja e vlerës.....	22
3.2 Vlera e pritshme, e perceptuar dhe e dorëzuar e konsumatorit.....	22
3.3 Si e kuptojnë konsumatorët e ndryshëm vlerën?.....	24
3.4 Ndërveprimi i klientit dhe furnizuesit.....	25
3.4.1 Krijimi i vlerës.....	26
3.5 Zbatimi i strategjisë marketing.....	27
3.5.1 Llojet e strategjive marketing.....	28
<b>KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E STUDIMIT</b>	
4.1 Metodologjia.....	31

4.2 Dizajni i studimit të rastit.....	32
4.3 Mbledhja e të dhënave.....	32
4.3.1 Studimi i rastit zgjidhet.....	32
4.3.2 Procesi i mbledhjes së të dhënave.....	33
4.4 Besueshmëria dhe vlefshmëria.....	34
4.5 Përshkrim i bankave të marra në studim.....	35
<b>KAPITULLI V: REZULTATET E STUDIMIT</b>	
5.1 Përshkrimi i studimit.....	40
5.2 Rezultatet e studimit.....	41
5.3 Rezultatet e studimit për klientët.....	48
Konkluzione.....	53
Bibliografia.....	56
Shtojca 1.....	59
Shtojca 2.....	62

## **KAPITULLI I: HYRJE**

### **1.1. Shqyrtime të përgjithshme dhe hyrëse**

Shumë kompani të shërbimit në botë angazhohen në ofrimin e më shumë se një shërbimi për klientët e saj. Kompanitë identifikojnë mangësitë, të cilat duhet të evitohen (shmangen), në mënyrë që të përmbushin nevojat e konsumatorëve duke ofruar një sërë shërbimesh dhe produktesh nëpërmjet aplikimit të një strategjie të caktuar marketingu. Çdo organizatë që dëshiron të jetë e suksesshme në bërjen e biznesit duhet të përqëndrojë burimet e saj në mundësitë më të mëdha për të rritur shitjet dhe për të arritur një avantazh të qëndrueshëm konkurrues. Kjo është e vërtetë për kompanitë e mëdha. Prandaj, strategjia e marketingut është një përgjigje afatgjate ndaj kontekstit socio-ekonomik të një mjedisi evolutiv dhe përfshin vendime themelore se si të përputhen burimet me atë mjedis që ndryshon. Kompania e Shërbimeve të Integruara të Objekteve është një kompani që ofron më shumë se një produkt ose shërbim për klientët e saj. Këto shërbime ose produkte mund të shkojnë nga shërbimet inxhinierike, konsultimi, instalimi dhe menaxhimi i projekteve, furnizimi me energji dhe menaxhimi etj. Cilido varg shërbimesh të ofruara nga kompania, në mënyrë që ajo të ketë një pjesë të mirë të tregut, patronazhit të vazhdueshëm nga konsumatorët dhe një marzh të fitimit të mirë, është e rëndësishme që ajo të ketë një strategji efektive të marketingut. Në kushte bashkëkohore të afarizmit nga menaxherët kërkohen gjithnjë e më tepër njohuri praktike nga lëmi i marketingut, me qëllim të implementimit të suksesshëm të marketingut operativ, dhe bashkë me të realizimin e suksesshëm të procesit të vendosjes së marketingut, që nënkupton se puna e suksesshme e menaxherit të marketingut në tërësi varet nga niveli i njohurive për konsumatorin, si në aspektin kreativ po ashtu edhe në atë aplikativ.<sup>1</sup>

### **1.2. Koncepti dhe përkufizimi i marketingut dhe menaxhimi i marketingut**

---

<sup>1</sup> Shih: Marios Theodosiou, Leonidas C. Leonidou, *Standardization versus adaptation of international marketing strategy: an integrative assessment of the empirical research*, International Business Review, 2003, vol. 12, issue 2, fq. 141-171.

Fjala marketing vjen nga fjala Angeze “market” që do të thotë treg. Kur fjalës market i shtohet sufiksi “ing” formohet termi “marketing” që në gjuhën shqipe ka kuptimin “tregëtim”. Për më tepër, marketingu është i ndërthurur me disa koncepte të caktuara, me ç’rast si pikënisje janë nevojat dhe dëshirat njerëzore të cilat përfshijnë nevojat elementare jetësore deri tek kërkesat në qarkullim, edukim, argëtim dhe zbavitje të ndryshme.<sup>2</sup> Në këtë kontekst, vlen të vihet në dukje dallimi midis nevojave, dëshirave dhe kërkesave si nocione të veçanta me domethënie të ndryshme kuptimore. **Kërkesa** pasqyron **dëshirën** për produkte të specifikuar të cilët janë në disponim, por paraprakisht dëshirat duhen mbështetur në aftësinë blerëse. **Nevojat**, ndonjëherë nuk janë të identifikuara qartë ose paraqesin problem të cilin duhet zgjedhur (me të mira materiale, paisje etj.).



Fig. 1. Konceptet e rëndësishme të marketingut

**Me produkt ose prodhim**, në kuptimin e gjerë të fjalës nënkuptohet çfarëdo qoftë oferte (prodhim, shërbim, ide, etj) e cila mund t’i plotësoj dëshirat dhe nevojat konsumatorit.<sup>3</sup>

Problemi marketing lind atëherë kur subjektet vendosin që nevojat e tyre t’i plotësojnë me ndihmën e “ndërthurjes së formave të ndryshme me rrjetin e marketingut”. Transaksionet midis shitësit dhe blerësit mund të kryhen në treg si punë komerciale (tregtare). Koncepti i shkëmbimit është i ndërlidhur me tregun si vend ku ndeshen kërkesa, nga njëra anë, dhe oferta, nga ana tjetër.<sup>4</sup>

<sup>2</sup> Nexhbi Veseli, *Bazat e Marketingut*, Tetovë, 2009, fq. 9-10.

<sup>3</sup> Ibid, fq. 10.

<sup>4</sup> Nexhbi Veseli, *Bazat e Marketingut*, Tetovë, 2009, fq. 11.

Ekzistojnë përkufizime të shumta dhe të ndryshme për marketingun nga pikëpamja teorike-shkencore. Sipas Kotlerit “Marketingu është mekanizëm ekonomik dhe social përmes së cilit individët dhe grupet kënaqin nevojat dhe dëshirat e tyre në procesin e krijimit të shkëmbimit të produkteve dhe përbërësve të tjerë të vlerës”. Nga ana tjetër, përkufizimi i Rocco-s për marketingun bashkëkohor është: “Marketingu bashkëkohor shënon aktivitetin afarist i cili ndërlihd prodhimin me konsumin në atë mënyrë që maksimalisht të kënaqin nevojat shoqërore të cilat në treg paraqiten si kërkesa”. Ndërkohë, R. Ohraz-i, marketingun e konsideron si sistem integral të aktiviteteve, objektiv i të cilit është, që prodhimtaria, shitja e mallit dhe shërbimet të harmonizohen me kërkesat e tregut në interes të ekonomisë nacionale. Së fundmi dhe përfundimisht, përcaktohem për përkufizimin më të qëndrueshëm të nocionit të marketingut që është dhënë nga Asociacioni Amerikan i Marketingut (*American Marketing Association*) sipas së cilit marketingu është një proces i qeverisjes i cili identifikon, parashikon dhe plotëson dëshirat, kërkesat e nevojat e konsumatorëve duke i sjellur benefit (fitim) prodhuesit.

Kuptimet bazike të marketingut janë:

- lëmia shkencore;
- konceptimi i marketingut;
- funksioni afarist dhe,
- procesi ekonomik.

**Si lëmi shkencore;** marketingu hulumton aktivitetet, mënyrat dhe format të cilat mundësojnë efektivet dhe efikasitet të shërbimit, si dhe të harmonizimit të prodhimit dhe konsumit.

**Konceptimi marketing;** është parim qendror, orientim bazik dhe doktrinë e organizatës (fitimprurëse dhe jofitimprurëse) duke u bazuar në rolin e vetë që ka në ekonomi dhe shoqëri.

**Marketingu si funksion afarist;** mund të organizohet në forma të ndryshme për të qenë i pranishëm në ndërmarrje.

**Marketingu si proces ekonomik;** ndërthurën prodhimin dhe konsumin duke kontribuar në suksesin e procesit të shkëmbimit.<sup>5</sup>

---

<sup>5</sup> Nexhbi Veseli, Bazat e Marketingut, Tetove, 2009, faq, 11-12.



Konsumatorët përbëjnë esencën (thelbin përmbajtësor) të çdo modeli biznesi, përfshirë edhe bankat. Teza diskuton një sërë modelesh të strategjisë së marketingut dhe rekomandon një model për ekipet marketing që duhet të ndiqen kur eksplorojnë opsionet komerciale për një teknologji apo produkt të ri, me ç'rast studimi është zhvilluar, kryesisht , në bazë të të dhënave empirike nga ku të gjithë punonjësit janë treguar, si rregull, kooperativ (bashkëpunues) në kuadër të bankave përkatëse - Banka Komerciale, Banka Ekonomike dhe Banka Teteks.

Në kapitullin e parë të këtij punimi janë paraqitur tema e punimit të Masterit, objektivat e studimit, tezat hulumtuese dhe hipotezat për arsye që të hidhet një dritë mbi të gjithë se çfarë aspektesh do të përfshijë punimi dhe se cilat janë strategjitë më të mira marketingut të cilat stimulojnë vlerat konsumatore.

Në kapitullin e dytë është zhvilluar një rishikim literature për t'u njohur me konceptet teorike të strategjive marketing të cilat mundësojnë zhvillimin e biznesit dhe rrisin vlerat konsumatore, literatura e vendosur në këtë pjesë të studimit është përzgjedhur duke pasur si shembull bankat të mëdha, siç janë: Banka Komerciale, Banka Ekonomike dhe Banka Teteks.

Në kapitullin e tretë është shqyrtuar metodologjia e përdorur për të realizuar studimin e cila siç e theksua më sipër është dhe empirike dhe analitike e cila pasohet me kapitullin e katërt ku janë paraqitur rezultatet e studimit në grafikë dhe tabela për të dhënë një pasqyrë më të qartë të studimit dhe të merret informacioni i duhur në lidhje me objektivat kryesorë të studimit.

## **1.2. Arsyetimi studimit**

Krijimi i planeve dhe strategjive të marketingut që kontribuojnë në shpenzimet efektive të burimeve dhe promovimin e përfitimit për konsumatorët është një detyrë për udhëheqësit e biznesit të të gjitha përmasave si bizneset e vegjël ashtu dhe bizneset e mëdhenj. Sfida për drejtuesit e kompanive është ndërtimi i marrëdhënieve me klientët nëpërmjet marketingut, veçanërisht për shkak të kufizimeve të burimeve. Strategjitë e marketingut për kompanitë e mëdha janë të ndryshme për shkak të këtyre burimeve financiare që zakonisht janë të kufizuara. Ekzekutimi strategjik i analizës së tregut duhet të jetë

konkurrues, dhe të përshtaten strategjitë e marketingut për të përmbushur të ardhurat e synuara dhe qëllimet e përfitimit të cilat janë detyrat për drejtuesit e bankave të mëdha të sipërtheksuara.

Aftësia për të reaguar ndaj ndryshimeve në kushtet e tregut është një faktor i brendshëm që ndikon në ecurinë e biznesit. Menaxherët e bankave për të arritur të gjitha objektivat duhet patjetër të rrisin vlerat konsumatore në një masë të konsiderueshme duke u mbështetur në faktin se konsumatorët janë ata të cilët bëjnë që bizneset të maksimizojnë fitimin dhe të jenë konkurrues në treg.

### **1.3. Qëllimi**

Qëllimi i kësaj teme është që, nëpërmjet një studimi të arrihet të evidentohet mbarëvajtja e sistemit bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe rentabilitetin (produktivitetin) e shërbimeve bankare duke u përballur me mundësitë e promovimit të produkteve bankare nëpërmjet strategjisë së marketing-ut. Marketingu, si një disiplinë e biznesit, është adaptuar nga institucionet bankare të sektorit privat dhe publik. Në fakt, qëllimi i këtij studimi është të evidentojë zbatimin e strategjive marketing në bankat konkrete: Banka Komerciale, Banka Ekonomike dhe Banka Teteks të cilat do të maksimizojnë benefitin bankar në të ardhmen, por njëkohësisht edhe do të rrisin maksimalisht vlerat konsumatore dhe do tërheqin konsumator të rinj duke shtuar numrin e konsumatorëve. Pas evidentimit të dy aspekteve të mësipërme do të vihet në dukje se si do të jetë zbatimi më i mirë në praktikë i këtyre strategjive marketing në Bankën Komerciale, Bankën Ekonomike dhe Bankën Teteks.

### **Objektivat**

Objektivat kryesore të studimit janë:

- Të paraqesë strategjitë e suksesshme të marketingut për tërheqjen e klienteve;
- Të analizojë strategjitë e sukseshme të përdorura nga bankat për tërheqjen e klienteve dhe ofrimin e vlerës në këto banka;
- Të japë rekomandimet e duhura për bankat: Bankën Komerciale, Bankën Ekonomike dhe Bankën Teteks reth aplikimit të strategjive të tyre të

marketingut duke u bazuar në të dhënat empirike.



#### **1.4. Sistemi Bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Sistemi bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përbëhet nga Banka Popullore e Maqedonisë së Veriut si banka qendrore në nivel shtetëror, statusi – organizimi, puna dhe kompetencat (të drejtat dhe detyrimet) e së cilës përcaktohet me Ligjin Për Bankën e Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe nga bankat dhe degët e bankave të huaja, statusi i të cilave përcaktohet nëpërmjet Ligjit për Bankat të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Së këndejmi, në përputhje me Ligjin për Bankat e Republikës së Maqedonisë së Veriut banka është personi juridik me licencë (leje) nga guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut e themeluar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, veprimtaria themelore e së cilës është grumbullimi i depozitave monetare dhe burimeve të tjera të kthyeshme nga publiku dhe përdorimi i tyre për dhënie kredie e vendosje në emër dhe për llogari të vet.<sup>6</sup>

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut është autoriteti që mbikëqyr bankat, degët e bankave të huaja<sup>7</sup> në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe degët e bankave të licencuara nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut<sup>8</sup> nga pikëpamja e ushtrimit të veprimtarisë së tyre bankare dhe financiare. Për më tepër, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut realizon procesin e mbikëqyrjes, kryesisht dhe, në radhë të parë, nëpërmjet: licencimit; analizës financiare dhe parashikuese, verifikimit të të dhënave të raportuara periodikisht nga bankat ose degët e bankave të huaja; inspektimeve të veprimtarisë bankare; marrëveshjeve të bashkëpunimit me autoritetet e huaja mbikëqyrëse dhe me bankat e huaja që kanë hapur degën ose filialin e tyre në territorin e

<sup>6</sup> Закон за банките, („Службен весник на Република Македонија“ бр. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15. 190/16 и 7/19).

<sup>7</sup> “Degë e bankës së huaj” është dega e një banke të licencuar për të kryer veprimtari bankare nga autoriteti përgjegjës i një vendi tjetër, të ndryshëm nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Kjo degë licencohet nga Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe regjistrohet në regjistrin e shoqërive tregtare.

<sup>8</sup> “Degë e bankës” është njësi organizative në varësinë e bankës, e cila ushtron në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjitha apo disa nga veprimtaritë që ushtron banka, në emër dhe për llogari të bankës përkatëse.

Republikës së Maqedonisë së Veriut. Subjektet e këtij ligji vënë në dispozicion të Bankës së Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dokumentacionin e nevojshëm, me qëllim realizimin e procesit të mbikëqyrjes. Në përmbushjen e funksionit të saj mbikëqyrës, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut vlerëson ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e ushtrimit të veprimtarisë bankare dhe financiare, aftësinë e një banke ose të degës së bankës së huaj për administrimin e rrezikut,<sup>9</sup> me të cilin ajo përballet dhe urdhëron marrjen e masave për të eliminuar shkeljet dhe parregullsitë e vërejtura, si dhe për përmirësimin e situatës financiare të bankës ose degës së bankës së huaj. Banka e Shqipërisë ka të drejtë t'i kërkojë autoritetit mbikëqyrës të bankës së huaj informacionin e nevojshëm lidhur me mbikëqyrjen e personave të lidhur me këtë bankë. Banka e Shqipërisë ka të drejtë të kërkojë informacion nga shoqëritë që kanë pjesëmarrje influencuese në banka dhe shoqëritë që janë në zotërim të përbashkët me bankat, për qëllim të mbikëqyrjes së bankave.

Sistemi bankar, në ekonomitë e organizuara dhe që funksionojnë sipas parimeve të tregut të lirë, është i ndarë në dy nivele. Ndarja e sistemit bankar në nivele bëhet për të identifikuar funksionet e ndryshme që kryejnë Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut si bankë qendrore në nivelin e parë dhe e bankave tregtare në nivelin e dytë, që, si rregull, kryejnë përgjithësisht aktivitete tradicionale, pra grumbullimin e depozitave dhe dhënien e kredive, fokusi i të cilëve janë klientët e vegjël dhe të mesëm. Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut si bankë qendrore është një person juridik, me pavarësi (mëvetësi) administrative, financiare dhe menaxheriale. Në nivelin e dytë qëndrojnë bankat tregtare. Këto banka janë ndërmjetës të pastër financiarë, të ngritura në formën e shoqërive aksionere dhe që kanë si qëllim sigurimin e fitimit për pronarët e tyre.<sup>10</sup>

Banka është shembulli më tipik i një ndërmjetësi financiar. Historikisht, roli i tyre ka qenë grumbullimi i kursimeve të ekonomisë në formën e depozitave

---

<sup>9</sup> "Administrimi i rrezikut" është tërësia e metodave dhe e rregullave që përdoren nga banka ose dega e bankës së huaj për identifikimin, monitorimin dhe administrimin e rreziqeve, me qëllim shmangien e humbjeve financiare.

<sup>10</sup> Shih: Љупчо Трпески, *Банкарство и банкарско работење*, Скопје, 2009; Љупчо Трпески, *Пари и банкарство*, Скопје, 2003.

dhe vënia e këtyre kursimeve në dispozicion të sektorëve të ekonomisë që kanë nevojë, në formën e kredive. Por, zhvillimi i shpejtë i sistemit financiar, i shoqëruar me rritjen e konkurrencës midis ndërmjetësve financiarë, ka bërë që bankat të zgjerojnë ndjeshëm gamën e veprimtarisë së tyre. Me këtë rast, në formë koncize do shpërfaqen funksionet kryesore të industrisë bankare:<sup>11</sup>

- Banka është një ndërmjetës financiar. Ajo grumbullon depozita nga një numër i madh personash dhe i jep këto depozita hua. Në këtë këndvështrim, esenca e biznesit bankar është përpunimi i informacionit për të lehtësuar këtë fluks monetar dhe për të rezultuar fitimprurëse.

- Bankat realizojnë një vëllim të madh pagesash në ekonomi, për llogari të firmave apo individëve. Në mungesë të bankave, pjesa më e madhe e pagesave do të bëhej me *cash*, me gjithë mangësitë e theksuara që shfaq një sistem i tillë.

- Bankat tregtare janë esenciale për transmetimin e politikës monetare në ekonomi. Këto banka janë hallka e parë e zinxhirit të mekanizmit të transmetimit. Mungesa e tyre do ta bënte të pamundur ndikimin e autoriteteve në ekonomi; kjo e fundit do të zhvillohej me luhatje, duke ulur ritmin e zhvillimit. Trendet e fundit të zhvillimit të bankave. Industria bankare në botë është duke pësuar ndryshime të shpejta strukturore. Këto ndryshime vihen re jo vetëm në vendet e zhvilluara, por edhe në ato në zhvillim. Monitorimi dhe vlerësimi i këtyre prirjeve është shumë i rëndësishëm dhe çdo politikë e hartuar në mbështetje të kreditimit të sektorit privat duhet t'i mbajë parasysh ato.

1. Teknologjia e informacionit. Aplikimi i teknologjive më të fundit informatike do të jetë forca kryesore e zhvillimit të industrisë bankare në të ardhmen. Informatizimi i procesimit të informacionit do të ulë koston e transaksioneve dhe, nëpërmjet bankingut elektronik (e-banking), do të ndryshojë mënyrën e komunikimit të klientëve me bankat.

2. Derregullimi. Tradicionalisht, industria bankare ka qenë një biznes shumë i mbrojtur dhe i rregulluar me ligj. Së fundi, derregullimi (tendenca e reduktimit dhe e thjeshtimit të ligjeve) ka ndryshuar fytyrën e industrisë bankare në të gjithë botën. Në vend të kontrollit të normave të interesit të depozitave apo kufijve të kredisë, fokusi i rregullimit dhe mbikëqyrjes bankare tani ka kaluar në përcaktimin e procedurave dhe sistemeve të përshtatshe për

---

<sup>11</sup> Shkëlqim Cani, *Banka Qendrore dhe Sistemi Bankar në Shqipëri*, Tiranë, 2004, fq. 8.

eliminimin e rrezikut. Në të shkuarën, segmenti bankar gëzonte një situatë pothuajse monopoliste brenda sektorit të ndërmjetësve financiarë. Sot, po vihet re një rritje e konkurrencës jo vetëm në sektorin bankar por edhe në atë financiar. Rrjedhojë e kësaj është marrja e një rreziku më të madh nga bankat.

3. Konsolidimi. Derregullimi i sektorit ka sjellë një konsolidim të shpejtë të sektorit dhe një rritje të bashkimeve të bankave. Këto bashkime justifikohen me ekonomitë e shkallës dhe uljet e kostove që ato sigurojnë. Kjo nuk do të thotë se një bankë e vogël nuk mund të jetë efiçente, por numri i bankave të tilla do të vijë në rënie në të ardhmen.

4. Privatizimi dhe pronësia e huaj. Privatizimi, kryesisht në pronarë të huaj, është një tjetër trend i qartë në industrinë bankare. Bankat shtetërore dhe ato "kombëtare" janë duke humbur terren, si pasojë e globalizimit. Ky proces kërkon një vizion më të gjerë dhe një strategji ndërkombëtare për të mbijetuar në këtë sektor.

5. Ndryshimi i sjelljes së bankave. Një tendencë e vërejtur së fundmi, është fakti se firmat po i drejtohen gjithnjë e më shumë tregut financiar për financim (kryesisht bursave), duke anashkaluar bankat. Gjithsesi, mundësinë reale për t'iu drejtuar direkt tregut financiar e kanë një numër firmash, kryesisht të mëdha. Bizneset e vogla dhe të mesme do të vazhdojnë të mbështeten në bankat për të siguruar financime.

Funksionet që përmbushin bankat tregtare ilustrojnë qartë rolin e tyre në një ekonomi tregu, si në vendet në zhvillim ashtu edhe në vendet e zhvilluara. Për këtë arsye, stabilitetit të sistemit bankar i kushtohet një rëndësi e madhe, si në literaturë ashtu edhe në praktikë.<sup>12</sup>

### **1.5. Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat**

1. Cilat janë strategjitë e marketingut që përdoren për të mbajtur klientët aktualë dhe për të fituar klientë të rinj?
2. Si ndikojnë strategjitë e marketingut në rritjen e vlerës së klienteve?
3. Cilat janë strategjitë që ndihmojnë maksimizimin e përfitimit?

---

<sup>12</sup> Shkëlqim Cani, *Banka Qendrore dhe Sistemi Bankar në Shqipëri*, Tiranë, 2004, fq. 9-10.

## **Hipotezat**

**H<sub>1</sub>:** Zbatimi i një strategjie të mirëfilltë marketingu rrit ndjeshëm vlerat konsumatore;

**H<sub>2</sub>:** Rritja e vlerave konsumatore maksimizon fitimin e firmës.

## **1.6. Rëndësia e studimit**

Strategjitë marketing janë shumë të rëndësishme për konsolidimin e një kompanie në treg, por ato bëhen akoma dhe më të rëndësishme kur rrisin vlerën konsumatore dhe ky është fokusi i këtij studimi. Rëndësia e këtij studimi është si teorike, por edhe praktike, pasi synon të ndihmojë kompaninë e marrë në studim për zhvillimin akoma dhe të mëtejshëm të strategjive marketing si dhe të ndihmojë me informacion praktik studentët të cilët studiojnë marketing dhe janë në prag të punësimit të tyre.

## **1.7 Kufizimet per realizimin e studimit**

Tema përballlet me pengesa e vështirësi si:

- mungesa e studimeve në këtë fushë; mungesa e burimeve të informacionit për çështje të pazgjidhura që lidhen me standartizimin e të dhënave statistikore në fushën e studimit të marketingut në kompanitë e vendit tonë;
- burokracitë për sigurimin e informacionit të nevojshëm nga bankat konkrete: Komercijalna Banka, TTK Banka dhe Stopansk Banka.

## KAPITULLI II: RISHIKIMI I LITERATURËS

### 2.1 Marrëdhënia midis strategjisë marketing dhe klientit

Marrëdhënia ndërmjet kënaqësisë së klientit dhe performancës financiare të një firme është ilustruar nga shumë studime të mëparshme. Studimet e mëparshme kanë zbuluar gjithashtu se cilësia e çmimeve dhe shërbimeve janë të lidhura ngushtë me kënaqësinë e konsumatorëve me ofruesit e shërbimeve dhe kanë shqyrtuar ndikimet e drejtpërdrejta të cilësisë së çmimeve, shërbimit në fitimet, pjesëmarrjen e një firme dhe në sjelljen e blerjes së konsumatorit. Megjithatë, marrëdhënia midis strategjisë së marketingut dhe kënaqësisë ose rritjes së vlerës konsumatore vazhdon të tërheqë vëmendjen nga akademikët dhe praktikuesit, duke pasur parasysh faktin se blerja e përsëritur tenton të ulet. Në përgjithësi, ofruesit e shërbimeve manipulojnë strategjinë e tyre të çmimeve ose cilësinë e shërbimit për të ndikuar në kënaqësinë e klientëve dhe për të ndërtuar më tej avantazhin e tyre konkurrues në tregun përkatës. Strategjia e çmimeve dhe strategjia e cilësisë së shërbimit kanë të bëjnë me planifikimin taktik të mbuluar nga planifikimi i përgjithshëm i strategjisë së firmës. Me fjalë të tjera, nivelet specifike të cilësisë së çmimeve dhe shërbimeve varen nga planifikimi i shpërndarjes së burimeve brenda firmës. Nga ana tjetër, ndërkombëtarizimi i aktiviteteve të biznesit bëhet gjithnjë e më i përhapur, strategjitë globale të marketingut (*Global Marketing Strategies - GMS*) po marrin vëmendje të konsiderueshme nga akademikët dhe praktikuesit. Pretendohet se suksesi apo dështimi i një biznesi në shekullin e njëzet e një do të varet nëse ai mund të konkurrojë në mënyrë efektive në tregjet globale. Studimet e mëparshme kanë diskutuar strategjitë globale të marketingut (GMS) nga tre perspektiva (standardizimi, koordinimi i konfigurimit dhe integrimi) dhe sugjerojnë se qëllimi i zhvillimit të marketingut global të marketingut (GMS) është të rrisë performancën një firme e cila rritë dhe vlerën konsumatore.<sup>13</sup> Megjithatë, mekanizmat e marrëdhënieve ndërmjet strategjisë së marketingut dhe kënaqësisë së klientit ende nuk janë hulumtuar në detaje. Është veçanërisht e vështirë për të vlerësuar efektet e strategjive të marketingut për industrinë e

---

<sup>13</sup> Bradley Frank, *International Marketing Strategy*, London, 2007, fq, 85-88.



shërbimit të karakterizuar nga paprekshmëria, prishja, ndryshueshmëria dhe pandashmëria. Përveç qartësimit të rolit ndërmjetësues të cilësisë së çmimeve dhe shërbimit në marrëdhëniet midis një strategjie marketingut dhe kënaqësisë së klientit, studimi merr në konsideratë ndikimet e përmasave të ndryshme të aspekteve të ndryshme të strategjive të marketingut.<sup>14</sup> Çdo aspekt është i ndryshëm, por jo i ndërsjellë ekskluziv. Prandaj, perspektiva e standardizimit dhe perspektiva e koordinimit-integrimit duhet të studiohen njëkohësisht duke ndryshuar peshat e tyre. Në mënyrë të veçantë, efekti i strategjive të marketingut varet nga pesha e secilit aspekt të strategjive të marketingut. Prandaj, ky studim fokusohet në efektet indirekte të strategjisë së marketingut në rritjen e vlerës konsumatore nëpërmjet çmimit dhe cilësisë së shërbimit. Argumentohet se kënaqësia e konsumatorit është çelësi i performancës financiare dhe firmat mund të shfrytëzojnë strategji në lidhje me çmimin dhe cilësinë e shërbimeve për të ndikuar drejtpërdrejt në kënaqësinë e konsumatorit, gjë që do të ndikojë në performancën financiare.<sup>15</sup>

Një kornizë konceptuale është zhvilluar në bazë të një sërë shqyrtimesh të literaturës. Përveç kësaj, propozohet rreptësisht që matematika, si gjuhë e shkencës, lejon ndërveprimin midis hulumtimeve empirike dhe teorike. Prandaj, një model matematikor është thelbësor për të lidhur teorinë dhe studimin empirik në mënyrë që të vlerësohet efektiviteti i strategjive të marketingut. Më pas, modeli matematikor aplikohet për të shpjeguar rolet ndërmjetësuese të cilësisë së çmimeve dhe shërbimit. Për më tepër, përshkruhet metodologjia e analizës empirike. Në këtë drejtim, një nga sfidat që një kompani duhet të përballojë është konkurrenca në tregun global. Megjithëse hulumtimet e kohëve të fundit kanë dhënë një kontribut të konsiderueshëm në njohuritë tona në hartimin e strategjisë së marketingut, ato rrallë konsiderojnë ndikimin e qëndrimeve të klientëve apo rivalëve dhe ndikimin e variablave ndërmjetës, siç janë çmimi ose cilësia e shërbimit.

Në një mjedis shumë konkurrues, modeli i monopolit do të pësojë polemikë dhe pyetje të pashmangshme. Për të modeluar strategjinë e avancuar të

---

<sup>14</sup> Steenkamp J. The role of national culture in international marketing research. *Int Mark Rev* 2001;18(1):30–44.

<sup>15</sup> Soares, A. M., Farhangmehr, M., & Shoham, A. (2007). Hofstede's dimensions of culture in international marketing studies. *Journal of Business Research*, 60, 277–284.

marketingut për të rritur kënaqësinë e klientit në një mjedis konkurrues, ky studim përpiqet të zhvillojë modelin matematikor bazuar në konceptimin e teorisë së lojës. Prandaj, qëllimi i parë i këtij studimi është aplikimi i teorisë së lojës për të analizuar rolin e qëndrimeve të klientëve dhe rivalëve në arritjen e një strategjie dominuese të marketingut. Për të zhvilluar kornizën konceptuale të integruar për strategjinë e marketingut, qëllimi i dytë është të ekzaminojë rolet ndërmjetësuese të cilësisë së çmimeve dhe shërbimeve në marrëdhëniet ndërmjet strategjisë së marketingut dhe kënaqësisë së klientit me anë të një modeli matematikor dhe një studimi empirik.<sup>16</sup> Në fakt, ndikimi i strategjisë së marketingut në kënaqësinë e klientit nën resurset e dhëna meriton konsideratë të mëtejshme. Qëllimi i tretë është identifikimi i udhëzimit optimal të strategjisë së marketingut nën burimet e dhëna. Për qartësi, ky studim ngre katër çështje që lidhen me strategjinë e marketingut në bazë të një modeli matematikor dhe studimit empirik.

*Së pari*, ndikimi i strategjisë së marketingut është i kushtëzuar nga pjesëmarrja e klientëve besnikë të kompanisë.

*Së dyti*, politikat e çmimeve dhe të shërbimeve të rivalëve të firmës mund të dominojnë strategjinë e saj të marketingut.

*Së treti*, udhëzimet optimale të strategjisë së marketingut, duke pasur parasysh burimet e kufizuara, do të rrjedhin për të siguruar një drejtim për alokimin e burimeve strategjike.

*Së katërti dhe së fundi*, modeli i ekuacionit strukturor do të përdoret për të shqyrtuar ndërlidhjet ndërmjet konstrukteve të hulumtimit për të ilustruar qëndrueshmërinë dhe kontributet e modelit matematikor.

Krijimi i vlerës së klientit përmes planifikimit strategjik të marketingut diskuton një qasje që është e dyanshme dhe e rrënjosur në marketingun dhe teorinë e strategjisë. Ky studim udhëzon lexuesin përmes procesit të shkrimit të një plani strategjik marketingu. Sugjerimet për përdorimin e mjeteve ndihmojnë për t'i zbatuar ato me sukses.<sup>17</sup>

---


<sup>16</sup> Sivakumar K, Nakata C. The stampede toward Hofstede's framework: avoiding the sample design pit in cross-cultural research. *J Int Bus Stud* 2001;32(3):555–74.

<sup>17</sup> Raghbir, P. (2006). An information processing review of the subjective value of money and prices. *Journal of Business Research*, 59, 1053–1062

## 2.2. Çfarë quajmë vlerë konsumatore?

Vlera është diçka që është e padefinuar dhe shuma e vlerës së një produkti ose shërbimi është ajo që perceptohet nga klienti. Kjo do të thotë se i njëjti produkt mund të ketë vlera të ndryshme në varësi se cili klient duhet ta vlerësojë vlerën. Kjo jep një aluzion në lidhje me vështirësitë për të dhënë një përkufizim të saktë të vlerës së klientit. Për të përcaktuar se si vlerësohet vlera në tregun B2B, kuota më poshtë është përzgjedhur si përkufizimi i vlerës së klientit për këtë tezë. "Vlera në tregjet e biznesit është vlera në terma monetare të përfitimeve teknike, ekonomike, shërbimi dhe sociale. Për shkak të mjedisit të biznesit shumë konkurrues, klientët ekzistues dhe potencialë do të krahasojnë vlerën e perceptuar nga oferta të ndryshme. Fituesi i rendit është furnizuesi që arrin të japë vlerën më të mirë nga perspektiva e klientëve, komponentët e ndryshëm që prekin vlerën e perceptuar mund të formohen në një model.

Figura 1.1. Komponentët e vlerës



### **Çmimi**

Në literaturën ekonomike mund të hasim përkufizime të ndryshme të çmimit, si p.sh., *çmimi është shprehje monetare e vlerave; çmimi është sasia e parave të cilat blerësi është i gatshëm t'i paguaj shitësit për njësi malli, çmimi është sasia e mallit; çmimi është baraspesha mes ofertës dhe kërkesës, i shprehur në para.*<sup>18</sup>

<sup>18</sup> Nexhbi Veseli, Bazat e Marketingut, Tetovë, 2009, fq. 175.

## ***Imazhi***

Imazhi ka të bëjë me reputacionin e furnizuesit dhe konsumatori formon një perceptim të imazhit të furnitorit nga burime të ndryshme. Imazhi bëhet i rëndësishëm nëse është e vështirë për konsumatorin të vlerësojë karakteristikat e produktit, shërbimit dhe çmimeve të furnitorit.<sup>19</sup>

## ***Kualiteti i produktit***

Cilësia e produktit i referohet karakteristikave fizike të një produkti që një klient vlerëson. Kjo përfshin mundësinë për të prodhuar në cilësinë e duhur dhe që ka aftësinë për të prodhuar një produkt të caktuar.

## ***Cilësia e shërbimit***

Cilësia e shërbimit trajton çështje të tilla si njohuri, ndihmë dhe çështje të shërbimit të klientëve të qendrave të thirrjeve, trajtimeve të ankesave, trajtimit të informacionit dhe disponueshmërisë së informacionit. Meqenëse shumica e furnitorëve brenda një industrie të caktuar kanë të njëjtat aftësi për të prodhuar një produkt specifik, ky faktor është bërë më i rëndësishëm për konsumatorin në mënyrë që të diferencohen në mes të konsumatorëve.<sup>20</sup>

Një dimension i pestë i vlerës shfaqet kur klienti ka marrë një vendim blerjeje. Ky dimension përfshinë marrëdhënien ndërmjet klientit dhe furnizuesit. Ky dimension mund të bëhet një çështje veçanërisht e rëndësishme për të ruajtur konsumatorët aktualë. Megjithatë, furnizuesit shpesh kanë strategji të sakta se si të zhvillojnë katër dimensionet e paraqitura në model, por nuk kanë kuptim se si të maksimizojnë përfitimet e marrëdhënieve të mira. Vlera është ajo që konsumatori beson se ata do të marrin për një shumë të caktuar parash. Ajo që është e rëndësishme për të identifikuar është se vlera është më shumë se produkti fizik që i ofrohet klientit dhe kjo është ajo që e bën të vështirë të kuptojmë se çfarë vlere ka. Më tej, Anderson dhe Narus (1998) japin modelin e mëposhtëm me qëllim që të përfytyrojmë atë që e bën një ofertë më tërheqëse

---

<sup>19</sup> Sondergaard M. Research note: Hofstede's consequences: a study of reviews, citations and replications. *Organ Stud* 1994;15(3):447–56.

<sup>20</sup> Pieters, Rik, MichelWedel and Jie Zhang (2007), "Optimal Feature Advertising Design under Competitive Clutter," *Management Science*, 53 (11), 1815–28.

sesa një tjetër. Vështirësitë qëndrojnë në vënien e një shifre në vlerë pasi konsumatorët e ndryshëm kanë mendime të ndryshme se cilat vlera janë të rëndësishme për ta. Ekuacioni gjithashtu nënkupton se çmimi nuk është kriteri i vetëm kur një klient vlerëson se cilin furnizues vendosin të përdorin.<sup>21</sup>

Në vitet e fundit, ndryshimet dinamike të fushës së biznesit global kanë qenë gjithmonë një temë me interes në qarqet menaxheriale. Njerëzit të shqetësuar për globalizimin ekonomik, aleancat strategjike dhe internetin, ata gjithashtu njoftuan për ndryshimet e mëdha të grupeve të konsumatorëve, dhe kështu për biznesin zgjidhja strategjike del nga një ndikim i thellë. Konsumatorët e sotëm nuk janë më marrës pasivë të produkteve dhe shërbimeve, ata kanë më shumë njohuri, informacione dhe aftësi, madje edhe të etur për të mësuar dhe praktikuar. Ata kanë iniciativë në përzgjedhjen e një produkti gjithnjë e më të gjerë. Si rezultat, kompanitë që përpiqen të mbajnë konsumatorët do të jenë në gjendje të marrin përparësi konkurruese afatgjate në konkurrencën e ashpër të tregut. Që nga vitet 1970, studiuesit dhe menaxherët e bizneseve vazhdojnë të eksplorojnë qasjet e reja që përshtaten me ndryshimet në marketing, nga fokusimi në produktin në cilësinë e produktit, në "orientimin e klientit" në kënaqësinë e klientit dhe besnikërinë. Koncepti i vlerës së konsumatorit, koncepti i marketingut arrin një nivel të ri krahasuar me konceptin tradicional të marketingut, inovacioni i vlerës së klientit është që kompania qëndron në perspektivën e konsumatorëve për vlerën e produkteve dhe shërbimeve. Kjo vlerë nuk përcaktohet nga kompania, por nga perceptimi aktual i konsumatorit. Në këtë kuptim, vlera e konsumatorit është vlera e perceptuar e konsumatorit. Kjo është ekuilibri midis përfitimeve të perceptuara të marrjes dhe mungesës. Sipas një shkriktari amerikan përshkruan vlerën e klientit si: të ardhurat nga konsumatori minus shumën e kostos së saj për produktet dhe shërbimet. Në një farë mase, të ardhurat formojnë vlerën.<sup>22</sup>

